



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.29/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada dhe Faton Ademi anëtarë, me zyrtarin ligjor, Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në objekte publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, kështu që subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), dega në Prishtinë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1300 (njëmijë e treqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimin të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 02.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkangjitur si dëshmi fotografit e printuara nga vendi i ngjarjes, si dhe një CD. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 01.06.2017, në rrugën “Meto Bajraktari” në afërsi të Pro Credit Bankës, në rrugën “ Luan Haradinaj “ në një objekt banesor dhe tek ora në sheshin “ Zahir Pajaziti” në Prishtinë, monitoruesi ynë ka hasur në poster të kandidatit për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) të ngjitur në objekte publike dhe në orën publike në sheshin qendror të qytetit. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se subjekti politik KDTP ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatit për deputet në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur disa fotografi të printuara si dhe një CD me fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 03.06.2017, KDTP, thekson se lidhur me pretendimet e Institutit Demokratik të Kosovës dhe urdhëresës së PZAP-it për të ndërmarrë masa përmisuese, kanë informuar se posterat e kandidatit për deputet nga subjekti i tyre politik të vendosura në objektet publike të cekura në ankesë i kanë larguar menjëherë pas marrjes së shkresës për urdhër nga PZAP - i.

Në cilësinë e provës, përgjigjes në ankesë ia kanë bashkangjitur foton që e dëshmojnë largimin e posterit të kandidatit të tyre në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) janë të vendosura në objektet publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik KDTP, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se posteri i kandidatit për deputet nga ky subjekt politik janë vendosur në objekte publike, si dhe nga përgjigja e ofruar nga subjekti politik KDTP nuk është mohuar shkelja e lartcekur, mbi këtë bazë paneli konsideron se subjekti politik i lartcekur ka kryer vepra penale të kundërligjshme të parapara në nenin 33.b e LZP-së.

Paneli e urdhëroi subjektin politik, KDTP, për ta përmirësuar shkeljen e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime e duhura për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë posterat e kandidatit të tyre nga vendi ku ka ndodhur shkelja, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e subjektit politik KDTP, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit për deputet nga subjekti politik KDTP, janë vendosur në objekte publike ashtu si qëndron në ankesë, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit në fjalë që ka ndërmarrë veprimi për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr.29/2017 më datën 05.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

**Zyhydi Haziri**



**Kwshilla Juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.